

Pyetje të shpeshta

Inventari i emisioneve të ndotjes së ajrit në Kosovë

Çka është inventari i emisioneve të ndotjes së ajrit?

Inventari i Emisioneve të ndotjes së ajrit tregon vendndodhjen e caktuar dhe sasinë e ndotësve që lirohen në ajër nga burime të ndryshme.

Për çka shërben inventari i emisioneve të ndotjes së ajrit?

Inventari i Emisioneve të ndotjes së ajrit është një nga mjetet kryesore që përdoret në menaxhimin e cilësisë së ajrit. Ky inventar na bënë të kuptojmë se cilët janë kontribuesit relativ të burimeve të ndotjes së ajrit. Ky inventar mundëson ndërmarrjen e veprimeve efektive për të zvogëluar emetimet dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit ambiental.

Kush e krijoi këtë inventar të emisioneve të ndotjes së ajrit?

Inventari i emisioneve të ndotjes së ajrit në Kosovë u krijua nga NIRAS si pjesë e projektit të Fondacionit të Mileniumit të Kosovës (MFK) të quajtur: 'Menaxhimit i projektit për cilësinë e ajrit, sistemit informues, ndryshimit të sjelljes dhe shërbimet e komunikimit', financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (KSM).

Ku mund ta gjej inventarin e emisioneve të ndotjes së ajrit?

Vetë inventari i emisioneve është i përbërë nga një seri fletëllogaritjesh në Microsoft Excel të cilat përmbajnë të dhëna për burimet e ndotësve. Ato fletëllogaritje shoqërohen nga një raport i cili përshkruan mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe gjetjet kryesore. Të gjitha këto janë në dispozicion në linkun <http://ammk-rks.net/?page=1,162>

Cili është dallimi midis 'emisioneve' dhe 'përqendrimeve në ambient'?

'Emisionet' paraqesin sasinë e ndotjes së emetuar nga burime individuale si oxhaqet (në instalimet industriale, shtëpitë, zyrat etj.) ose aktivitete si transporti apo minierat. Ato zakonisht paraqiten si një masë e ndotësve gjatë një periudhe kohore, p.sh. mega gramë në vit (Mg/vit). Ky është fokusi i Inventarit të Emisioneve.

'Përqendrimet në mjedis' paraqesin sasinë e një ndotësi në ajër në një vend të jashtëm ku dikush ka të ngjarë të ekspozohet ndaj tij. Niveli i ndotësit në një vend të caktuar ndikohet nga burimet e emetimeve (kryesisht ato afër, por edhe nganjëherë ato shumë larg) pasi ata të kenë kaluar një farë niveli të 'shpërndarjes' në atmosferë. Përqendrimet e ambientit zakonisht paraqiten si një masë për vëllim të ajrit, p.sh. mikrogramë për metër kub ($\mu\text{g} / \text{m}^3$). Kjo nuk është ajo që përfaqëson Inventari i Emisioneve. Por, Inventari i Emisioneve është një burim jetësor i të dhënave hyrëse në një model shpërndarjeje i cili më pas mund të përdoret për të llogaritur përqendrimet në mjedis.

A mund ta përdor Inventarin e Emisioneve të ndotjes së ajrit për të kontrolluar përqendrimet e mjedisit në vendbanimin tim?

Jo. Inventari përmban të dhënat vetëm për burimet e ndotjes dhe nuk përcakton se cilat janë përqendrimet në mjedis të ambientit.

Çfarë ndotësish përfshin Inventari dhe pse u zgjodhën?

Inventari i Emisioneve të ndotjes së ajrit të Kosovës përqendrohet në ndotësit e mëposhtëm: PM10, PM2.5, oksidet e azotit (NOx), dyoksidi i sulfurit (SO2), monoksidi i karbonit (CO), bashkëdyzimet organike të paqëndrueshme (BOP), arseni (As), kadmiumi (Cd), merkuri (Hg) dhe plumbi (Pb). Këta ndotës janë përzgjedhur sepse të gjithë mund të kenë ndonjë efekt negativ të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut.

Pse Inventari nuk përfshin dyoksid karbonin (CO2) dhe gazra të tjerë serë?

Qëllimi i projektit nën të cilin u zhvillua Inventari ka të bëjë posaçërisht me sigurimin e informacionit më të mirë për ndotësit që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e njeriut, sesa për ata ndotës që kontribuojnë në ndryshimin e klimës.

Nga u siguruan të dhënat e shfrytëzuara për të krijuar Inventarin e Emisioneve?

Krijimi i inventarit të emisioneve është bazuar në një metodologji të siguruar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit duke u mbështetur në të dhënat ekzistuese në Kosovë. Këtu përfshihen të dhënat nga inventarët e tjerë të krijuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), dhe Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (AJBN) për zona specifike të Kosovës.

Në nivel kombëtar, të dhënat u mblodhën nga institucione të tilla si Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Infrastrukturës si dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës. Në nivelin lokal, të dhënat u mblodhën nga autoritetet komunale nëpër Kosovë. Në disa raste, të dhëna specifike janë marrë nga studime të tjera të tilla si ato të ndërmarra nga Bashkimi Evropian (BE).

Cilat janë gjërat kryesore që na ofron Inventari i Emisioneve?

Burimet më të mëdha të emetimeve të PM10 dhe PM2.5 janë djegiet e vogla, kryesisht ngrohja shtëpiake. Në përgjithësi, pothuajse 50% e PM10 dhe 68% e PM2.5 vjen nga djegiet e vogla. Industria është e dyta për nga madhësia me 37% për PM10 dhe 24% për PM2.5. Transporti, kryesisht trafiku rrugor, është burimi i tretë me 11% dhe 7% të pjesëmarrjes përkatëse. Sektorët tjerë përbëjnë më pak se 5% të emetimeve.

Industria dhe transporti, kryesisht trafiku rrugor, janë burimet më të mëdha të emetimeve të NOx. Industria përfaqëson 57% dhe transporti 30%.

Industria është burimi më i madh i emetimeve të SO2 me 96%.

Shumica e emetimeve të PM10, PM2.5 dhe NOx ndodhin në zonat urbane dhe përgjatë rrugëve kryesore.

A i ka marrë parasysh Inventari i Emisioneve ndryshimet në emisione në lidhje me pandeminë COVID-19?

Jo. Të dhënat për në inventar përfaqësojnë vitin 2018.